REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA R. SHEHU
ADRESA Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3
TEL: 0692091283

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 8483** **Nr. koleksioni: 3854**

**Tirane më 25/09/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2024052820420691466

***Akti noterial përbëhet nga 7 fletë**

A2024052820420691466

**KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI**

**TE SHOQERISE "BNT ELECTRONICS" SHPK**

Sot, më datë 28/09/2024 , para meje Notere MIMOZA R. SHEHU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3/3, u paraqit personalisht:

**DHURUES**:
Jona Bojdani, atësia Jovan, amësia Teuta, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANË, me adresë Sami Frashëri; Nd. 13, H. 10, Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5, 1019; Tiranë, lindur më 25/03/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 039532111 dhe nr. personal J85325051U.

(Ortak zotesues i kuotave ne 16.67% te kapitalit te shoqerise)

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhururesi**")*

**PRANUES I DHURIMIT**:
Teuta Bojdani, atësia Eqrem, amësia Lirie, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Sami Frashëri, Nd. 13, H. 10, Ap. 33; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5, 1019; Tiranë, lindur më 04/01/1963, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034008969 dhe nr. personal G35104055C.

(Ortak zotesues i kuotave ne 16.67% te kapitalit te shoqerise)

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")*

**Rrethanat e hartimit të aktit noterial:**

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

**Baza Ligjore**

*Neni 761 e vijues të Kodit Civil; Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"*

**PARASHTRIMET:**

1. Shoqëria **"BNT ELECTRONICS"** sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e themeluar sipas legjislacionit, regjistruar ne regjistrin tregtar, te mbajtur pranë Qendrës

A2024052820420691466

Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik Identifikimi të Subjekti ("**NUIS**"): NUIS J61817047D, me adresë: Bulevardi "Zhan D`Ark" Nd. 32, hyrja 16, kati 2, Ap.1, Tirane (*në vijim referuar si* "**Shoqëria**")

2. Bazuar ne Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është **270,000,000 leke (dyqind e shtatedhjetemilion )** i ndarë si vijon:

    a. Teuta Bojdani, zotëruese e 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 45,000,000.00 (dyzete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e gjashte* ) % të kapitalit të Shoqërisë;

    b. Jona Bojdani, zotëruese e 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 45,000,000.00 (dyzete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate*) % të kapitalit të Shoqërisë;

    c. Kristi Bojdani, zotëruese e 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 45,000,000.00 (dyzete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 16.66 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate*) % të kapitalit të Shoqërisë;

    d. Leonard Terpo, zotëruese e 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 135,000,000.00(njeqind e tridhjete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 50.00 (pesedhjete)% të kapitalit të Shoqërisë;

    Dhuruesi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 45,000,000.00 (dyzete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate*)% të kapitalit të Shoqërisë;

3. Dhuruesi dhe njëherazi Ortaku i Shoqërisë, dëshiron të tjetërsojë pjeserisht kuotën që ajo zotëron në Shoqërinë, nëpërmjet dhurimit tek Pranuesi i Dhurimit.

4. Pranuesi i Dhurimit nga ana tjetër pranon dhurimin e bërë nga Dhuruesi dhe shprehet se dëshiron të bëhet pronare edhe i kuotës që Dhuruesi zotëron tek Shoqëria.

5. Organet kompetente të Shoqërisë, të Dhuruesit dhe të Pranuesit të Dhurimit kanë miratuar të gjitha vendimet e nevojshme për miratimin e këtij transaksioni për kuotën.

**PËR KËTË ARSYE,** në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

A2024052820420691466

**NENI 1**
**PARASHTRIMET, SHTOJCAT DHE INTERPRETIMI**

1.1 Parashtrimet /Shtojcat

Parashtrimet dhe dokumentet bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate dhe do të interpretohen sipas kuptimit të këtij neni.

1.2 Interpretimi

Përveç se kur konteksti i kësaj Kontrate kërkon ndryshe:
(i) fjalët e secilës gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;
(ii) termat "*të kësaj*", "*këtu*", "*nëpërmjet kësaj ose nga kjo*", "*në këtë*" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë Neni, Paragrafi, Bashkëlidhje apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;
(iii) Parashtrimet, Shtojcat, dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të saj dhe referencat në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet do të jenë referenca në Shtojcat dhe Bashkëlidhjet e kësaj Kontrate, përveç kur Palët merren vesh ndryshe.
(iv) referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti; dhe referenca në një ligj do të thotë referencë në një ligj të tillë, siç mund të jetë ndryshuar, rinxjerrë apo ribërë;
(v) fjalët "*përfshin*" ose "*duke përfshirë*" do të konsiderohet se pasohen nga "*pa kufizim*" ose "*duke mos u kufizuar në*", edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;
(vi) referencat në "*kjo kontratë*" ose në çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë kontratë ose dokument, të ndryshuar, modifikuar, ose shtuar dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë dokument, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj;
(vii) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "*ditësh*" ky numër do t'i referohet ditëve kalendarike, përveç kur shprehimisht specifikohen si Ditë Pune;
(viii) titujt e Neneve, Kapitujt dhe Nenet në këtë Kontratë janë bërë vetëm për qëllime lehtësimi dhe reference, dhe këto nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate.

**NENI 2**
**OBJEKTI I KONTRATES**

a. Objekt i kësaj Kontrate është transferimi me anë të dhurimit, të 1 *(një)* kuote, që Dhuruesja **Jona Bojdani** zotëron në Shoqëria **"BNT ELECTRONICS"** sh.p.k, me vlerë nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate*) % të kapitalit të Shoqërisë; në favor të Pranuesit të Dhurimit.

**NENI 3**
**DEKLARIMET DHE GARANCITË**

A202405282042069l466

**3.1** <u>Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit</u>

*(a) Pronar i Ligjshëm*

Dhuruesi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i kuotës se zotëruar prej tij në Shoqëri dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontratë, dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj.

*(b) Barrët mbi Pronën*

Dhuruesi deklaron se kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk është e ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguruese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontrate çdo personi, duke përfshirë çdo të drejte blerje, opsioni ose të drejtë parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontrata të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përmbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cënonte titullin e pronësisë së Pranuesit të Dhurimit mbi kuoten objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

*(ç) Garancia*

Në bazë të njohurive më të mira të Dhuruesit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi në lidhje me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklarimet dhe garancitë e Dhuruesit të paraqitura më sipër janë të vërteta dhe të sakta.

**3.2** <u>Detyrimet e Dhuruesit</u>

*(a) Nënshkrimi i Akteve*

Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të nënshkruajë çdo akt e të kryejë çdo veprim juridik pa vonesa, kur i kërkohet nga Pranuesi i Dhurimit, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, e që mungesa e të cilit do të pengonte ushtrimin e plotë, të pakushtëzuar e të pakufizuar prej Pranuesit të Dhurimit të së drejtës së tij të pronësisë mbi ketë kuotë.

*(b) Mbrojtja Gjyqësore*

Në rastin kur një palë e tretë (përfshi autoritetet publike) ngre pretendime dhe/ose bën ankime gjyqësore për të kundërshtuar titullin e pronësisë të Pranuesi i Dhurimit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, ose duke u bazuar në pretendime të mëparshme cenon apo kundërshton të drejtat që burojnë nga kjo kuotë, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të thirret/ndërhyjë në gjykimin e çështjes, dhe me shpenzimet e saj të mbrojë interesat e Pranuesit të Dhurimit si të ishin të tijat.

*(c) Cënimi i Titullit*

Pa kufizuar të drejtat e tjera të Pranuesit të Dhurimit të përcaktuar me ligj, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të mbrojë, zhdëmtojë, dëmshpërblejë, dhe ruajë Pranuesin e Dhurimit, ndaj dhe në vlerën e plotë të: (i) çdo detyrimi, dëmi, humbjeje, apo shpenzimi, përfshi këtu shpenzimet e avokatit apo të ekspertëve të Dhuruesit që rezultojnë nga dokumente zyrtare

A202405282042069l466

(kontrata, fatura), të pasur nga Pranuesi i Dhurimit për t'u mbrojtur nga çdo pretendim, kërkesë, apo padi, proces a vendim gjyqësor, përmbarimor të një të treti (*për qëllimet e këtij neni, i tretë quhen edhe autoritetet publike kur veprojnë në rastet e parashikuara me ligj*) që duke u hequr si pronar i ligjshëm, kundërshton titullin e pronësisë të Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate.

## NENI 4
## TË NDRYSHME

4.1 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë Parashtrimet dhe Shtojcat bashkëngjitur saj, përbën tërësinë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe zëvendëson çdo ose të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me pjesët objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të kryhet me shkrim dhe të miratohet nga palët përndryshe do të konsiderohet e pavlefshme.

4.2 Veçueshmëria e Kontratës

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme dhe/ose e paligjshme dhe/ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Palët në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

4.3 Njoftimet

a Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:

(i) bëhet në gjuhën shqipe;

(ii) bëhet me shkrim;

(iii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, dhe

(iv) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjerë të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.

**b** Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tjetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të

A2024052820420691466

ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë te shpejte dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër, në adresat e deklaruara prej palëve.

**NENI 5**
**EFEKTE LIGJORE**

5.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar me të drejta të plota të kuotës së dhuruar, sipas përcaktimit të Objektit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këtë kuotë.

5.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:

a. Teuta Bojdani, zotëruese e 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 90.000.000,00 (nentedhjetemije) Lekë, që i korrespondojnë 33.34 (*trembedhjete pike tridhjete e kater*) % të kapitalit të Shoqërisë;

b. Kristi Bojdani, zotërues i 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 16.66 (*gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e gjashte*) % të kapitalit të Shoqërisë;

*c.* Leonard Terpo, zotërues i 1 (*një*) kuote, me vlerë nominale 135.000.000,00 (njeqind e tridhjete e pesemilion) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesedhjete*) % të kapitalit të Shoqërisë;

5.3 Pranuesi i Dhurimit merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("**QKB**") këtë Kontrate dhe ndryshimet përkatëse në pjesëmarrjen e kapitalit të Shoqërisë sipas pikës 5.2 të këtij neni të Kontratës.

**NENI 6**
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

6.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate (*në vijim referuar si* "**Mosmarrëveshje**"), secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

6.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Civil.

**NENI 7**

A2024052820420691466

## DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Kontrata dhurimit te kuotave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

| **DHURUESI** | **PRANUESI I DHURIMIT** |
|---|---|
| Jona Bojdani | Teuta Bojdani |
| Jona Bojdani | Teuta Bojdani |

**VENDIMI NR. 4**
**I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE ORTAKVE TE SHOQERISE**
**"BNT ELECTRONICS" SHPK me NIPT:**
J61817047D

Sot me date, 25/09/2024 ne seline e shoqerise **"BNT ELECTRONICS" SHPK**, me NIPT J61817047D u mblodh Asambleja e Zakonshme e Ortakve te shoqerise sipas lajmerimit te bere rregullisht lidhur me ndryshimin ne pjesemarrjen e ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

1. Teuta Bojdani, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate) % të kapitalit të Shoqërisë;

2. Jona Bojdani, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 16.67 (gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate) % të kapitalit të Shoqërisë;

3. Kristi Bojdani, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 16.66 (gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e gjashte) % të kapitalit të Shoqërisë;

4. Leonard Terpo , zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 135.000.000,00 (njeqind e tridhjete e pesemilion ) Lekë, që i korrespondojnë 50 % (pesedhjete) të kapitalit të Shoqërisë;

Asambleja e Zakonshme e Ortakve te shoqerise **"BNT ELECTRONICS" SHPK** . bazuar ne: Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", lidhur me ndryshimin ne pjesemarrjen e ortakeve ne kapitalin e shoqerise, shqyrtoi ceshtjen dhe **ne perfundim mbledhja e asamblese ortakeve te shoqerise "BNT ELECTRONICS" SHPK.**

**V E N D O S :**

1. Te miratoje transferimin e kuotave te kapitalit te shoqerise **"BNT ELECTRONICS" SHPK** me ane te dhurimit ne masen 16.67 % (gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e shtate) qe i perkasin ortakut Znj. Jona Bojdani, ne vlere nominale 45.000.000,00 (dyzete e pesemilion ) Lekë perkatesish tek ortaku Znj. Teuta Bojdani.
2. Pas efektit te trasferimit te kuotave, Znj. Teuta Bojdani rezulton te jete ortake e e shoqerise me 33.34% te pjesemarjes se kapitalit te shoqerise me vlerë nominale 90.000.000,00 (nentedhjetemije ) Lekë .
3. Largimin e ortakes Jona Bojdani .
4. Vendimi te depozitohet ne QKB, dhe te perditesohen efektet e ketij vendimi dhe kontrates shoqeruese te shitjes se kuotave, ne Regjistrin e Pronareve Perfitues.

Mbledhja u mbyll me miratimin e plote te ortakeve, ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**ORTAKET E SHOQERISE "BNT ELECTRONICS" SHPK**

| Teuta Bojdani | Jona Bojdani | Kristi Bojdani | Leonard Terpo |
|---|---|---|---|
| Teuta Bojdani | Jona Bojdani | Kristi Bojdani | |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | J61817047D |
| 2. Data e Regjistrimit | 24/05/1994 |
| 3. Emri i Subjektit | BNT ELECTRONICS |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 08/05/1994 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 08/05/1994 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë |
| 8. Kapitali | 270.000.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 270.000,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ne fushen e tregetise shoqeria do te kryeje: Tregtim, distribucion, import-eksport te mallrave te ndryshem ne pergjithesi, vecanerisht pajisje elektrike, elektronike, mekanike, kompjuterike, telekomunikacioni, rrjeti dhe sigurie, pajisje fundore dhe infrastrukture IT, fotokopjimi dhe riprodhimi te imazhit. Pajisje mjekesore te te gjitha llojeve duke perfshire edhe ato me rreze X, pajisje fiskale, kasa fiskale, printera fiskal te gjitha llojeve, POS, si edhe sisteme fiskale me sisteme te ndermjetme; Antiviruse dhe software te tjere per mbrojtjen e sistemeve informatike pajisjeve energjitike, pajisjeve printuese dhe fotokopjuese, pajisje te transmentimit me vale te te gjithe brezave te frekuencave duke perfshire edhe antena te cdo lloji, sisteme kondicionimi dhe sisteme me gaz duke perfshire edhe ato me presion te larte. 2. Ne fushen e sherbimeve shoqeria do te kryeje: Aktivitet ne fushen e sherbimeve si perfaqesues produktesh dhe kompanive te huaja dhe te vendit. Montim, instalim, konfigurim, integrim, mirembajtje, sherbime te ndryshme dhe trajnime te pajisjeve te ndryshme ne pergjithesi, vecanerisht pajisje elektrike, elektronike, pajisje fundore dhe infrastrukture IT, fotokopjimi dhe riprodhimi te imazhit, mjekesore te te gjitha llojeve duke perfshire edhe ato me rreze X, pajisje fiskale, printera fiskal te gjitha llojeve, POS, si edhe sisteme fiskale me sisteme te ndermjetme; pajisje te transmentimit me vale te te gjithe |

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | |
|---|---|
| | brezave te frekuencave 2 duke perfshire edhe antena te cdo lloji, sisteme kondicionimi dhe sisteme me gaz duke perfshire edhe ato me presion te larte, antiviruse dhe software te tjere per mbrojtjen e sistemeve informatike. Prodhim, projektim, programim, krijim, zhvillim, implementim, hostim, pershtatje dhe lokalizim, sipermarrje zbatuese, konfigurim, integrim, mirembajtje dhe trajnim per sisteme software te te gjitha llojeve, programe dhe aplikacione, dhe sisteme software on-premise, web-based, cloud dhe hybrid. Sherbim konsulence ne fushen e teknologjise se informacionit per dizenjimin dhe implemetimin e sistemeve hardware dhe/ose software. Sherbime hardware dhe software ne sektorin e teknologjise dhe te informacionit, telekomunikacionit, sherbimeve me vlere te shtuar, elektronikes dhe energjise, e pajisjeve te tjera qe jane te lidhura me to, dizenjim, instalim infrastrukture dhe mirembajfje te tyre. Sherbime printimi, skanimi dhe fotokopjimi, zgjidhje menaxhimi ne forme shitje ose me qira, shitje tonerash me shumice dhe pakice. Mbikeqyrje dhe kolaudim i punimeve te zbatimit ne ndertim. Punime te pergjithshme ndertimi. Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike. Ndertime per nenstacionet kabinat e transformatoreve, linja e tensionit te larte e te mesem dhe shperndarjen e energjise. Punime speciale ndertimi. Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj. Montimi e prodhimi i elementeve te pajisjeve te ndryshme elektronike, elektroteknike, elektromekanike perfshire kondicioner, elektroshtepiake etj te ketij lloji, te sisteme informatike fizik apo ne cloud, infrastrukture pajisjeve IT, sisteme software, programeve, sistemeve te pajisjeve fiskale, pajisjeve mjekesore, etj. Kryerjen e sherbimit, servisit dhe mirembajtjen e pajisjeve pajisje elektrike, mekanike, elektronike, kompjuterike, pajisje telekomunikacioni, rrjeti dhe sigurie, pajisje mjekesore, pajisje fiskale, kasa fiskale, pajisjeve energjitike, pajisjeve printuese dhe fotokopjuese, pajisje elektroteknike, elektromekanike perfshire kondicioner, elektroshtepiake etj te ketij lloji. Instalimin, konfigurimin, mirembajtje te sisteme informatike fizik apo ne cloud, infrastrukture pajisjeve IT, sisteme software sitemeve te pajisjeve fiskale, pajisjeve mjekesore, etj. Dhenien me qera te te gjithe sherbimeve te lartepermendura, pajisjeve, etj. 3. Ne fushen e Telekomunikacionit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin e impianteve te telekominikacionit dhe sherbimet e nderlidhjes ne internet, administrimi, vendosja dhe |

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB Qendra Kombëtare e Biznesit National Business Center

| | | |
|---|---|---|
| | perdorimi i impianteve fikse dhe te levizshme per transmetime radiotelevizive ose ekuivalente. Kryerja e cdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise per te cilen ne baze te legjislcionit shqiptar, kerkohet leje e posacme nga organet kompetente te administrates publike, do te realizohet vetem pasi te jete siguruar leja perkatese. | |
| 10. Administratori/ët | Kristi Bojdani | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 21/08/2024 | Deri: 20/08/2029 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | TeutaBojdani | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 45.000.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 45.000,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 16,67 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | JonaBojdani | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 45.000.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 45.000,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 16,67 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Ortakët | KristiBojdani | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 45.000.000,00 | Natyre: |
| 14.2 Numri i pjesëve | 45.000,00 | |
| 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 16,67 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 15. Ortakët | LeonardTerpo | |
| 15.1 Vlera e kapitalit | Para: 135.000.000,00 | Natyre: |
| 15.2 Numri i pjesëve | 135.000,00 | |
| 15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| | | |

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | |
|---|---|
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Automjet tip Volkswagen CADDY, me targa TR 6023 U Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.5, Bulevardi "Zhan D'ark", Kulla Nr.1, Kati 1 Tirane Tirane TIRANE Bulevardi " Gjergj Fishta ", Kulla 1 Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Bulevardi "Zhan D'Ark", Kulla III, Kati perdhe, Dyqani Nr.2 Tirane Tirane TIRANE Automjet tip Volkswagen Caddy me targe AA 621 ML me leje qarkullimi Nr TRDA7843115 Fier Fier FIER Lagjia "Kastriot", Rruga "Brigada e 11 Sulmuese", dyqani nr.6 Vlore Vlore VLORE L.Pavaresia,Rruga "Ismail Qemali" Vlore Objekti ndodhet ne Rezidencen Imperiale, nje banese 12 kate dyqani dhe 10 kate banimi Tirane Tirane TIRANE Rruga "Skender Kosturi", Nr. Pasurie 7/593 Korce Korçe KORCE Ne rrugen "28 Nentori" (Riza Cerova) i cili ne dokumentin e pronesise njihet si pasuria nr 4, seksioni A, kati perdhe, me siperfaqe prej 30 m2" Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 7, Bulevardi Zhan D'ark, Ndertesa Nr. 32, Kulla III, Kati i pare Nr. 16. (servis) Tirane Tirane TIRANE Rruga Kongresi i Manastirit, Pallati i ri 7 katesh i shoqerise LK&CTD, per magazine Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 7, Bulevardi Zhan D'ark, Ndertesa Nr. 32, Kulla III, Kati i pare Nr. 4. (magazine) Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Jordan Misja, Magazina me Zone Kadastrale 8330, Nr.pasurie 6/348 Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Blv. Zhan D'Ark, Ndertesa Nr.32, Sip.118.2 m2 Shkoder Shkoder SHKODER Lagjja Qemal Stafa, Bulevardi Zogu i Pare, prapa pallati nr. 1111, majtas njesi vegla auto, djathtas njesi kepuce |
| 17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: BNT ELECTRONICS<br>E-Mail: info@bntelectronics.com<br>Telefon: 0682029370 +35542273666<br>Të Tjera: Emerohet Z. Hetem Sulaj, Ekspert Kontabel i Autorizuar per pregatitjen e raportit per zmadhimin e Kapitalit Themeltare. |
| 18. Statusi: | Aktiv |

Kopje nga web

Datë: 25/09/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web